



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 172, Datë 18.05.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË ALPEX SH.A.
LIDHUR ME KOMITETIN E BURSËS SHQIPTARE TË ENERGJISË**

Në mbështetje të neneve 16, 18, pika 1, gërma “a” dhe “dh”; nenit 19 gërma “a”, neneve 57 dhe 98 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikave B. 2.2 , B. 3.3.1 dhe B.3.3.2 të “Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Kushtet e përgjithshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022; si dhe neneve 19 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, me nr. 1300/1prot., datë 17.05.2023 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së ALPEX sh.a. lidhur me Komitetin e Bursës shqiptare të energjisë”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë Rregullat e tregut të energjisë elektrike (Kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes).
- Shoqëria ALPEX sh.a. me shkresën nr. 128 prot., datë 19.04.2023, protokolluar me tonën me nr. 1300 prot., datë 24.04.2023, ka paraqitur për miratim procedurën e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.
- Në pikat B. 2.2, B. 3.3.1 dhe B.3.3.2 gërma “a” të Aspekteve ligjore dhe të qeverisjes, të Kushteve të Përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, përcaktohen ndër të tjera Roli i Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë si dhe përgjegjësia e ALPEX sh.a. për hartimin, përditësimin dhe paraqitjen për miratim pranë Autoriteteve Rregullatore të procedurës së Komitetit të Bursës.
- Procedura e paraqitur për miratim nga shoqëria ALPEX sh.a. përbëhet nga tetë kapituj, shtojca A me anëtarët e Komitetit fillestar të Bursës si dhe aplikimi për anëtarësim dhe pjesëmarrje në këtë Komitet.
- Ngritja e Komitetit të Bursës si një organ konsultativ i zgjedhur nga Anëtarët e Bursës është i nevojshëm për promovimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, që ato të mbeten aktuale dhe të përditësuara me kalimin e kohës, nëpërmjet konsultimit dhe këshillimit me ALPEX-in për ndryshimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

- Në pikën B.2.3.1 të rregullave, Përbërja e Komitetit të Bursës, përcaktohet se komiteti duhet të pasqyrojë llojshmërinë e Anëtarëve të Bursës, sipas tipit të licencave që anëtarët e Bursës zotërojnë. Ndërsa në pikën B.2.3.2 përcaktohet se Komiteti i Bursës do të përbëhet nga jo më shumë se 10 (dhjetë) anëtarë, ku 8 (tetë) anëtarë janë të zgjedhur nga Anëtarët e Bursës dhe dy anëtarë janë të emëruar nga ALPEX-i, ku njëri prej të cilëve do të jetë kryetari i Komitetit.
- Sikurse evidentuar dhe më sipër ky komitet ka një rol konsultativ për ALPEX sh.a. dhe në fazën fillestare të operimit të ALPEX që prej datës 11.04.2023, roli konsultativ i komunitetit mund të ketë ndikim pozitiv në operimin e bursës dhe në bërjen e propozimeve nëse është e nevojshme për përmirësimin e saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi

1. Fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. lidhur me procedurat e Komitetit të Bursës Shqiptare të Energjisë.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI